# EMERGENCY CARE & SIMULATION WORKSHOP: Enhancing Practical Clinical Skills Through International Collaboration

# Përmirësimi i Aftësive Klinike Praktike përmes Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Kujdesin Infermieror Simulator

- Programi Erasmus+ (mobilitet afat-shkurtër)
- Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", Shqipëri
- Tallinn Healthcare College, Estoni

**Periudha e aktivitetit:**



## 1. Qëllimi i raportit

Ky dokument paraqet zhvillimin dhe rezultatet kryesore të aktivitetit akademik “Emergency Care & Simulation Workshop”, i organizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar Erasmus+ ndërmjet Fakultetit të Shëndetit të Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali” dhe Tallinn Healthcare College, Estoni. Fokusi i aktivitetit ishte:

- Shkëmbimi i përvojave akademike dhe profesionale
- Përmirësimi i edukimit simulues në programet e infermierisë
- Zhvillimi i kompetencave praktike në kujdesin emergjent
- Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në fushën e shëndetit

Raporti shërben si dokument mbështetës për raportimin Erasmus+, transparencën dhe llogaridhënien akademike, proceset e akreditimit institucional të programeve të studimit dhe integrim të qëndrueshëm të teknologjive të reja në mësimdhënie.

## 2. Përshkrimi i aktivitetit

Workshop praktik **“Emergency Care & Simulation”** u bazua te:

- Simulimet praktike për menaxhimin e situatave emergjente
- Aplikimi i skenarëve baze trajnues për trajtimin e traumave dhe procedurat bazë të kujdesit
- Puna në grupe për të praktikuar teknikat e reagimit të shpejtë dhe kujdesit infermieror.

Gjatë aktivitetit, studentët punuan nën drejtimin e pedagogëve dhe ekspertëve ndërkombëtarë, duke zhvilluar ushtrime që simulonin situata reale klinike.

Workshopi shërbeu si:

- platformë për shkëmbim përvojash midis studentëve dhe ekspertëve.
- Nxitës i angazhimit aktiv të studentëve në mësimdhënie
- Përditësim mbi praktikat më të mira të edukimit simulues

Ai u shoqërua me leksione mbi tematikat “Kujdesi në trauma dhe menaxhimi i situatave emergjente përmes simulimeve” nga Siiri Maasen dhe Kaja Lempu.

## 3. Dimensioni Erasmus+ dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

Në përputhje me prioritetet e programit Erasmus+, aktiviteti kontribuoi në:

**3.1 Ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë**

- Shkëmbim përvojash ndërmjet Shqipërisë dhe Estonisë
- Përfshirje e studentëve dhe stafit në aktivitete akademike ndërkombëtare
- Forcim i bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e edukimit shëndetësor simulator

**3.2 Cilësinë dhe inovacionin në mësimdhënie**

- Integrim i metodave të edukimit simulues në trajtimin e situatave emergjente

**3.3 Zhvillimin profesional të studentëve dhe stafit**

- Përmirësim i aftësive praktike në kujdesin emergjent
- Përmirësim i aftësive bashkëpunuese dhe të komunikimit profesional në ekip.

## 4. Rezultatet akademike dhe institucionale

### 4.1 Inovacion pedagogjik – Simulation Education

- Përdorimi i edukimit simulues *(simulation education)* si metodë inovative për zhvillimin e aftësive praktike të studentëve të infermierisë.
- Prezantimi dhe adaptimi i modeleve të simulimit të përdorura në Tallinn Healthcare College (Estoni) për kontekstin akademik shqiptar.
- Zhvillimi i aftësive në komunikimin profesional, punën në grup dhe reagimin në situata emergjente përmes skenarëve simulues.
- Përforcimi i lidhjes ndërmjet njohurive teorike dhe praktikës klinike përmes trajnimit praktik.

### 4.2 Shkëmbimi i njohurive akademike

- Shkëmbim përvojash dhe njohurish ndërmjet studentëve dhe pedagogëve gjatë aktiviteteve praktike dhe diskutimeve.
- Bashkëpunim akademik ndërmjet pedagogëve të institucioneve partnere në metodologjitë e edukimit dhe praktikës klinike.
- Kontribut në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e edukimit në shkencat e shëndetit.

## 5. Ndikimi në sigurimin e cilësisë dhe akreditim

Aktiviteti jep kontribut si:

- Evidencë për bashkëpunim ndërkombëtar në zhvillimin e edukimit simulues.
- Përmirësim i rezultateve të të nxënit dhe kompetencave në kujdesin emergjent.
- Integrim i metodave inovative të mësimdhënies.

Ai shërben si:

- Mbështetje për sigurimin e brendshëm të cilësisë në arsimin e lartë.
- Kontribut në zhvillimin e programeve të studimit në shkencat e shëndetit.
- Evidencë e përputhjes me standardet evropiane për cilësinë në arsimin e lartë.

## 6. Diseminimi i rezultateve

- Shpërndarja e rezultateve u krye përmes publikimit institucional të raportit të aktivitetit, prezantimeve akademike dhe takimeve të brendshme.
- Integrimin e përvojës në zhvillimin e kurrikulave, si dhe komunikim dhe bashkrijim me partnerët Erasmus+.
- Grupet kryesore përfituese ishin studentët e programe të ciklit të parë dhe të dytë, stafi akademik dhe ndihmësakademik.

7. **Konkluzione:**

Ky aktivitet mundësoi:

- shkëmbim njohurish mes institucioneve,
- përditësim mbi praktikat më të mira të edukimit simulues, një komponent thelbësor për përgatitjen e profesionistëve të shkencave infermierore.
- forcim të bashkëpunimit ndërkombëtar

Workshopi konfirmoi rëndësinë e partneriteteve ndërkombëtare në përmirësimin e cilësisë së edukimit dhe kujdesit shëndetësor, duke krijuar mundësi të reja për zhvillim akademik dhe profesional.

Fotot dokumentojnë angazhimin aktiv të studentëve në simulime, bashkëpunimin në ekip dhe përdorimin e pajisjeve laboratorike për ushtrime praktike.







**PEDAGOGET PJESËMARRËS:**

Siiri Maasen – Tallinn Healthcare College

Kaja Lempu - Tallinn Healthcare College

Olesja Zeel - Tallinn Healthcare College

Fatjona Kamberi –Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali”

**STAF NDIHMËS AKADEMIK**

Vjollca Zahaj

**STUDENTËT PJESËMARRËS:**

1. Erisilda Tare
2. Denisa Braushaj
3. Irisa Amiti
4. Jurida Gjonaj
5. Nxhiko Pelari
6. Serxhio Ziu
7. Anxhela Qejvanaj
8. Andja Pelari
9. Varjola Kacabuni
10. Flavio Meta
11. Suada Isufi
12. Vasilika Danaj
13. Leonora Leka
14. Fatlume Seldiu
15. Xhoana Gjonaj
16. Elite Mustafa
17. Art Ismaili
18. Qazim Muji
19. Teuta Mucaj

**PËRGATITI DHE KOORDINOI AKTIVITETIN:**

**Prof. Asoc. Fatjona KAMBERI**

**Qëndra Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik**

**Fakulteti i Shëndetit**

**Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali”**

**2023**